Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrate
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove
01 Nr. 011/01-2747
Data/Datum 02.02.2021
Gjakovë-Djakovica-Gjakova

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

**Kuvendi i Komunës së Gjakovës**
**01 Nr. _____________/2021**
**Datë: 28.01.2021**

Kuvendi i Komunës së Gjakovës duke u bazuar në nenin 12, nenin 17 shkronja (b), neni 40 shkronja (l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28 qershor 2008), nenit 5 nen paragrafi 1.2. dhe nenet 10, 11, 15, dhe nenit 26 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 datës 31.07.2013 si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.11/15 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal, nenit 55 të Statutit të Komunës së Gjakovës 01 Nr. 011-10 datë 26.12.2008, pas diskutimeve lidhur me pikën e 6 të rendit të ditës : Shqyrtimi i kërkesës për nxjerrjen e vendimit për punimin e Planit Zhvillimor Komunal ( PZHK), e miratoj këtë:

# VENDIM

## PËR HARTIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL 2021-2028

### Neni 1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë vendim fillohet hartimi Planit Zhvillimor Komunal 2021-2028 i Komunës së Gjakovës .

### Neni 2

Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë vendim përkufizohet dokumenti i planifikimit hapësinor, Plani Zhvillimor Komunal, në harmoni me ligjin si plan strategjik multi-sektorial, i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Plani Zhvillimor i Komunal duhet të përfshijë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për periudhën tetë (8) vjeçare.

### Neni 3

Qëllimi i hartimit

Me Planin Zhvillimor Komunal nga neni 1 i këtij vendimi planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të

arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, rregullimit dhe ndërtimit të komunës së Gjakovës, plotëson kërkesat ligjore për të përgatitur planin strategjik multi-sektorial i cili përfshinë planifikimin dhe zhvillimin e zonës urbane dhe rurale.

### Neni 4

Kufiri i territorit

Zonat kadastrale në territorin e Komunës së Gjakovës janë:

| Kodi kadastral | Zona kadastrale | Sipërfaqja m² | Sipërfaqja Ha |
|---|---|---|---|
| 70705001 | BABAJ BOKES | 21.952.636 | 2195 |
| 70705007 | BERDOSANË | 10.516.590 | 1051 |
| 70705003 | BATUSHA | 9.425.412 | 942 |
| 70705005 | BEC | 15.385.911 | 1538 |
| 70705006 | BERJAH | 1.877.266 | 187 |
| 70713003 | BISTRAZHIN | 3.103.127 | 310 |
| 70705008 | BREKOC | 5.546.998 | 554 |
| 70705009 | BROVINË | 20.312.534 | 2031 |
| 70705079 | CERMJAN | 19.608.143 | 1960 |
| 70713017 | DAMJAN | 20.889.575 | 2088 |
| 70705020 | DEVA | 17.565.171 | 1756 |
| 70705024 | DOBLIBARE | 8.930.057 | 893 |
| 70705025 | DOBRIQ | 4.246.399 | 424 |
| 70705027 | DUJAKË | 5.880.565 | 588 |
| 70705077 | FIRZA | 8.721.497 | 872 |
| 70713016 | GËRQINË | 20.426.516 | 2042 |
| 70705017 | GRGOC | 9.598.717 | 959 |
| 70705028 | GJAKOVË-J.QYTET | 22.285.135 | 2228 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 70705029 | GJAKOVË-QYTET | 2.539.008 | 253 |
| 70713009 | GODEN | 10.664.325 | 1066 |
| 70705018 | GUSKË | 2.187.532 | 218 |
| 70705030 | HEREÇ | 5.212.950 | 521 |
| 70705034 | JABLLANICA | 7.332.754 | 733 |
| 70705037 | JAHOC | 10.438.679 | 1043 |
| 70705035 | JANOSH | 2.467.515 | 246 |
| 70705039 | KODRALIA BECIT | 6.096.167 | 609 |
| 70705042 | KORENICË | 5.033.844 | 503 |
| 70705043 | KOSHARE | 24.573.384 | 2457 |
| 70705044 | KRALAN | 14.929.595 | 1492 |
| 70705041 | KODRA HUTIT | 11.079.452 | 1107 |
| 70705045 | KUSHAVEC | 2.554.449 | 255 |
| 70713044 | LIPOVEC | 7.876.957 | 787 |
| 70705048 | MARMULL | 8.191.664 | 819 |
| 70705049 | MEÇE | 3.515.698 | 351 |
| 70705050 | MOGLICË | 3.856.125 | 385 |
| 70705051 | MOLLIQ | 8.432.584 | 843 |
| 70705052 | NIVOKAZ | 2.867.583 | 286 |
| 70705014 | NOVOSELLË E EPËRME | 3.078.130 | 307 |
| 70705022 | NOVOSELLË E ULËT | 3.682.673 | 368 |
| 70705053 | ORIZE | 3.951.848 | 395 |
| 70705055 | OSEKHYLE | 2.863.297 | 286 |
| 70705054 | OSEKPASHË | 1.306.630 | 130 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 70705056 | PALABARDH | 2.323.420 | 232 |
| 70705057 | PETRUSHAN | 16.763.284 | 1676 |
| 70705060 | PONOSHEC | 10.290.583 | 1029 |
| 70705061 | POPOC | 8.025.303 | 802 |
| 70705076 | QERIM | 7.530.716 | 753 |
| 70705081 | ÇERRET | 11.755.455 | 1175 |
| 70705067 | RAQË | 2.608.197 | 260 |
| 70705063 | RADONIQ | 11.180.861 | 1118 |
| 70705064 | RAKOC | 5.796.257 | 579 |
| 70710070 | ROGOVË II | 2.601.066 | 260 |
| 70713071 | ROGOVË I | 12.766.723 | 1276 |
| 70705066 | RRACAJ | 6.365.203 | 636 |
| 70705083 | SHEREMET | 10.498.832 | 1049 |
| 70705084 | SHISHMON I BOKËS | 12.724.274 | 1272 |
| 70705071 | SKIVJAN | 9.339.383 | 933 |
| 70713075 | SMAÇ | 4.805.336 | 480 |
| 70705073 | SMOLICË | 9.560.393 | 956 |
| 70705074 | STUBELL | 2.394.967 | 239 |
| 70705075 | TRAKANIQ | 3.398.518 | 339 |
| 70713080 | UJZ | 7.899.128 | 789 |
| 70705010 | VOGOVË | 3.552.417 | 355 |
| 70705012 | VRANIQ | 4.885.327 | 488 |
| 70705031 | ZHABEL | 12.989.235 | 1298 |
| 70705032 | ZHDRELLË | 3.389.908 | 338 |
| 70705033 | ZHUB | 7.759.963 | 775 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 70705070 | ZID SADIK AGE I | 2.989.440 | 298 |
| 70705085 | ZID SADIK AGA II | 876.914 | 87 |
| 70713029 | ZYLFAJ | 11.626.968 | 1162 |

Subjekti përgjegjës për hartim

Bartës i hartimit të Planit Zhvillimor Komunal është Autoriteti i Përgjegjës Komunal i Planifikimit dhe Menaxhimit Hapësinor në Komunë - Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartim

Mjetet për hartimin e dokumentit të planifikimit hapësinor sigurohen nga buxheti i komunës së Gjakovës. Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit koordinon procesin e hartimit e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal me drejtoritë sektoriale dhe burimet njerëzore brenda komunës.

**Neni 7**

Afati i hartimit

Bartësi i hartimit të dokumentit të planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi është i obliguar që dokumentin e planifikimit hapësinor ta hartojë në afat prej 12 muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

**Neni 8**

Konsultime Publike

Projekti i Planit Zhvillimor Komunal, para finalizimit do të vihet në konsultime publike dhe në shqyrtim publik. Paraqitja e Planit Zhvillimor Komunal në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen përmes njoftimeve publike.

**Neni 9**

Afati i Vlefshmërisë

Dokumenti i planifikimit hapësinor Plani Zhvillimor Komunal hartohet për periudhën kohore 8(tetë) vjeçare, respektivisht 2021-2028.

**Neni 10**

Gjuha zyrtare

Dokumenti i planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi duhet të jetë në gjuhët zyrtare të komunës dhe së paku në 3 (kopje) të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale të origjinalit .

**Neni 11**

Programi

Pjesë e këtij vendimi është programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit i paraparë me nenin 11 pika 1.3 të Ligjit për Planifikim Hapësinorë Nr. 04/L-174.

**Neni 12**

Hyrja ne fuqi

**1**.Me miratimin e këtij Vendimi nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës, shfuqizohet Vendimi për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal me nr. Protokolli 011/01-4768/2017 i datës 28.02.2017.

**2**.Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

**01Nr.________________**

**Datë 28.01.2021**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**z. Anton Shala**

Republika e Kosovës-Komuna e Gjakovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Opstina Dakovica-Muncipality of Gjakova

Programi i punës për hartimin dhe menaxhimin e Planit Zhvillimor Komunal

Për shkak të kërkesave të reja ligjore dhe mungesës së kapaciteteve njerëzore për të përgatitur Planin Zhvillimor Komunal, Komuna sipas praktikave të komunave fqinjë do të angazhoj kompani profesionale konsulente që të mbështes Komunën për të përgatitur Planin Zhvillimor Komunal(PZHK).

Aktivitetet të cilat duhet të ndërmerren gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal:

1. Punët para përgatitore

| Detyrat | Aktivitetet | Qëllimi | Kohëzgjatja | Përgjegjësi |
|---|---|---|---|---|
| 1.Përcaktimi I grupit punues | A.Përcaktimi udhëheqësit të projektit,koordinatorëve të drejtorive vijuese:<br>a.Drejt. për Punë të Përgjthshme Adminis.<br>b.Drejt. për Buxhet e Financa<br>c. Drejt. Për Arsim<br>d. Drejt. Për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale<br>e. Drejt. Për Shërbime Publike<br>f. Drejt. Për Punë Inspektuese.<br>g. Drejt. Për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural<br>h. Drejt. Për Mbrojtje dheShpëtim<br>i. Drejt. Për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit<br>j. Drejt. Për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë | Në mënyrë që PZHK të përgatitet, nevojiten të caktohen personat përgjegjës të cilët do të mbikëqyrin këtë proces dhe përmbajtjen që i përket drejtorive sektoriale. | 1 javë | Kryetari i Komunës |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | k. Drejt. Për Kulturë, Rini dhe Sport<br>l.Drejt.Për Zhvillim Ekonomik | | | |
| 2.Përcaktimi I grupeve të interesit | A.Përcaktimi igrupeve lokale të interesit,institucioneve të Qeverisë qendrore, organizata të jashtme që ofrojnë shërbime publike OJQ, biznese,përfaqësues të fshatrave dhe bashkësive lokale<br>B.Krijimi I listës dhe kontak-teve të pjesëmarrësve. | Në mënyrë që PZHK të përkrahet nha banorët e Komunës, nevojitet që të përcaktohen organizatat dhe përfaqësuesit e komuniteteve. | I javë | Udhëheqësi komunal i projektit |
| 3.Trajnimi i punonjësve të Komunës | A.Njoftimi i drejtorive rreth procesit të planifikimit hapësinor dhe PZHK-së nga kompania konsulente,<br>B.Trajnimi i punonjësve për shfrytëzim të GIS-it nga kompania konsulente | Në mënyrë që të përgatitet një dokument i harmonizuar dhe i qëndrueshëm, drejtoritë sektoriale duhet të njoftohen rreth implikimeve ligjore dhe të dhënave që nevojiten. | I javë | Kompania konsulente |
| 4.Hartimi i konceptit dhe planit të punës | A. Shqyrtimi i Kornizës Logjike të PZHK-së sipas UA dhe Ligjit,<br>B. Identifikimi i Rreziqeve/Kërcënimeve,<br>C. Vlerësimi i PZHK-së paraprake,<br>D. Analizimi i Planit Hapësinor të Kosovës që përcakton zhvillimet për Komunën | Në mënyrë që të zhvillohet një koordinim i qëndrueshëm i drejtorive sektoriale, nevojitet që të miratohet një strukturë e dokumentit mbi të cilin do të | 2 javë | Kompania konsulente dhe Udhëheqësi komunal i projektit |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | E. Krijimi i strukturës përmbajtësore të HZK-së.<br>F. Prezantimi i strukturës së dokumentit dhe konceptit të punës para drejtorive komunale | bazohet një plan i hollësishëm i punës përgjatë hartimit të PZHK-së | | |
| 5.Zhvillimi i takimeve njoftuese me banorët | A. Përgatitja e prezantimit të planit të punës dhe qëllimit të PZHK-së për takimin njoftues me banorët dhe GP.<br>B. Takimi njoftues me banorë të zonës urbane dhe GP<br>C. Katër takime njoftuese me banorë të zonave rurale | Në mënyrë që banorët dhe GP të jenë të njoftuar rreth metodologjisë së kontributit të tyre, nevojitet një takim njoftues. | 1 javë | Udhëheqësi komunal i projektit |

2. Grumbullimi dhe vlerësimi i të dhënave nga drejtoritë komunale

| Detyrat | Aktivitetet | Qëllimi | Kohëzgjatja | Përgjegjësi |
|---|---|---|---|---|
| 1.Grumbullimi i të dhënave komunale | A. Grumbullimi i të dhënave të drejtorive vijuese:<br>a. Drejt. për Punë të Përgjithshme Adminis.<br>b. Drejt. për Buxhet e Financa<br>c. Drejt. Për Arsim<br>d. Drejt. Për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale<br>e. Drejt. Për Shërbime Publike<br>f. Drejt. Për Punë Inspektuese.<br>g. Drejt. Për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural<br>h. Drejt. Për Mbrojtje dhe Shpëtim<br>i. Drejt. Për Urbanizëm | Në mënyrë që të përgatitet Profili i PZHK-së nevojitet që të grumbullohet të dhënat e kërkuara sipas UA për PZHK. | 2 javë | Udhëheqësi komunal i projektit |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | dhe Mbrojtje të Mjedisit<br>j. Drejt. Për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë<br>k. Drejt. Për Kulturë, Rinidhe Sport<br>l. Drejt. Për Zhvillim Ekonomik | | | |
| 2.Grumbullimi i të dhënave të nivelit qendror dhe kompanive publike. | A. Zhvillimi i takimeve dhe sigurimi i të dhënave të nevojshme nga ministritë përkatëse;<br>B. Zhvillimi i takimeve dhe sigurimi i të dhënave nga kompanitë publike. | Në mënyrë që të përgatitet Profili i PZHK-së nevojitet që të grumbullohet të dhënat e kërkuara sipas UA për PZHK | 2 javë | Udhëheqësi komunal i projektit |
| 3.Grumbullimi i të dhënave të operatorëve tjerë publik | A. Zhvillimi i takimeve dhe sigurimi i të dhënave të nevojshme nga furnizuesit me rrymë elektrike;<br>B. Zhvillimi i takimeve dhe sigurimi i të dhënave të nevojshme nga operatorët e telekomunikacionit;<br>C. Etj. | Në mënyrë që të përgatitet Profili i PZHK-së nevojitet që të grumbullohet të dhënat e kërkuara sipas UA për PZHK | 2 javë | Udhëheqësi komunal i projektit |
| 4.Vlerësimi i të dhënave nga konsulentët | A. Vlerësimi i të dhënave të grumbulluara nga konsulentët dhe formatizimi i tyre sipas UA për PZHK. | Në mënyrë që të dhënat të jenë në përputhje me kërkesat ligjore, nevojitet një vlerësim i plotësimit të këtyre kërkesave. | 1 javë | Kompania konsulente |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 5.Inkorporimi i sugjerimeve për të dhëna shtesë që ligjërisht kërkohen. | A. Plotësimi me të dhëna shtesë nëse kjo vlerësohet e nevojshme. | Të gjitha të dhënat e grumbulluara duhet të jenë ne përputhje me kërkesat e UA për PZHK. | I javë | Kompania konsulente dhe Udhëheqësi komunal i projektit |

3.Përgatitja e Profilit

| Detyrat | Aktivitetet | Qëllimi | Kohëzgjatja | Përgjegjësi |
|---|---|---|---|---|
| I.Përpilimi I përmbajtjes tekstuale, grafike dhe hartografike të Profilit Komunal. | A.Plotësimi I Profilit me të dhënat e grumbulluara, si vijon:<br>a.Historiku I zhvillimit të Komunës<br>b.Pozita<br>c.Gjendja ekzistuese demografike<br>d.Gjendja ekzistuese e veçorive mjedisore<br>e.Gjendja ekzistuese e zhvillimit ekonomik<br>f.Gjendja ekzistuese e infrastruktures teknike<br>g.Gjendja ekzistuese e infrastruktures se transportit dhe transporti public<br>h.Gjendja ekzistuese e infrastruktures publike<br>i. Gjendja ekzistuese e infrastruktures sociale<br>j.Gjendja ekzistuese e mjedisit dhe sip. Me rrezikshmëri<br>k.Gjendja ekzistuese e aseteve tjendja ekzistuese e aseteve të trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike<br>l.Gjendja ekzistuese e vendbanimeve<br>m.Gjendja ekzistuese e shfrytëzimit të tokës | Në mënyrë që të përgatitet Vlerësimi I Gjendjes Ekzistuese është I domosdoshëm të përgatitet pasqyra e gjendjes ekzistuese | 2 javë | Udhëheqësi komunal I projektit dhe kompania konsulente |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 2.Konsultimi I Profilit Komunal nga grupet punuese | A.Vlerësimi I Profilit nga KD<br>B.Vlerësimi I Profilit nga GP<br>C.Vlerësimi I Profilit nga konsulentet<br>D.Inkorporimi I komenteve dhe sugjerimeve | Në mënyrë që të kompletohet Profili I PZHK-së nevojitet që të grumbullohen të dhënat e kërkuara sipas UA për PZHK | 1 javë | KD, GP dhe Kompania Konsulente |
| 3.Shqyrtimi public I Profilit | A.Përgatitja e prezantimit të Profilit për shqyrtim public<br>B.Zhvillimi I shqyrtimit public të Profilit | Në mënyrë që të plotësohet Profili me të dhënat e fundit, është I nevojshëm prezantimi public I tij | 2 javë | Udhëheqësi komunal i projektit |
| 4. Plotësimi dhe përfundimi I Profilit | A.Inkorporimi I komenteve dhe sygjerimeve nga banorët | | 1 javë | Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente |

4.Përgatitja e Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese

| Detyrat | Aktivitetet | Qëllimi | Kohëzgjatja | Përgjegjësi |
|---|---|---|---|---|
| 1.Përpilimi i përmbajtjes tekstuale, grafike dhe hartografike të Profilit Komunal | A. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese në raport me synimet e Qeverisë Qendrore dhe standardeve hapësinore si vijon:<br>a. Gjendja ekzistuese e zhvillimit ekonomik<br>b. Gjendja ekzistuese e infrastrukturës teknike<br>c. Gjendja ekzistuese e infrastrukturës se transportit dhe transporti publik<br>d. Gjendja ekzistuese e infrastrukturës sociale<br>e. Gjendja ekzistuese e mjedisit dhe | Përpilimi i përmbajtjes tekstuale, grafike dhe hartografike të Profilit Komunal | 1 javë | Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | sipërfaqeve me rrezikshmëri<br>f. Gjendja ekzistuese e infrastrukturës publike<br>g. Gjendja ekzistuese e aseteve të trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike<br>h. Gjendja ekzistuese e vendbanimeve<br>i. Gjendja ekzistuese e shfrytëzimit të tokës | | | |
| 2.Konsultimi i Vlerësimit të gjendjes ekzistuese nga grupet punuese | A. Shqyrtimi i Vlerësimit të gjendjes ekzistuese nga KD<br>B. Shqyrtimi i Vlerësimit të gjendjes ekzistuese nga GP<br>C. Shqyrtimi i Vlerësimit të gjendjes ekzistuese nga konsulentët<br>D. Inkorporimi i komenteve dhe sugjerimeve | Konsultimi i Vlerësimit të gjendjes ekzistuese nga grupet punuese | I Javë | KD,GP dhe kompania konsulente |
| 3.Shqyrtimi public I Vlerësimit të gjendjes ekzistuese | A. Përgatitja e shqyrtimit publik të Vlerësimit të gjendjes ekzistuese për prezantim publik<br>B. Zhvillimi i shqyrtimit publik të Vlerësimit te gjendjes ekzistuese | Prezantimi publik i Vlerësimit të gjendjes ekzistuese | 2 javë | Udhëheqësi komunal i projektit |
| 4.Plotësimi dhe përfundimi i Vlerësimit të gjendjes ekzistuese | A. Inkorporimi i komenteve dhe sugjerimeve nga banorët | Plotësimi dhe përfundimi i Vlerësimit të gjendjes ekzistuese | I javë | Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente |

5.Përgatitja e SWOT analizës, Vizionit, Qëllimeve, Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike

| Detyrat | Aktivitetet | Qëllimi | Kohëzgjatja | Përgjegjësi |
|---|---|---|---|---|
| 1.Zhvillimi i punëtorisë për caktimin e SWOT analizës, Vizionit, Qëllimeve, Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike | A. Përcaktimi i agjendës dhe pjesëmarrësve në punëtori<br>B. Përcaktimi i SWOT analizës për:<br>a. Gjendjen ekzistuese të zhvillimit ekonomik<br>b. Gjendjen ekzistuese të infrastrukturës teknike<br>c. Gjendjen ekzistuese të infrastrukturës se transportit dhe transporti<br>d. Gjendjen ekzistuese të infrastrukturës sociale<br>e. Gjendjen ekzistuese të mjedisit dhe sipërfaqeve me rrezikshmëri<br>f. Gjendjen ekzistuese të infrastrukturës publike<br>g. Gjendjen ekzistuese të aseteve të trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike<br>h. Gjendjen ekzistuese të vendbanimeve<br>i. Gjendjen ekzistuese të shfrytëzimit të tokës<br>C. Përcaktimi i Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike për:<br>a. Zhvillimin ekonomik<br>b. Infrastrukturën teknike | Në mënyrë që planifikimi të jetë i harmonizuar dhe i qëndrueshëm, nevojitet që të zhvillohet një punëtori me KD, punonjës të drejtorive komunale dhe pjesëtar tjerë të GP | 1 javë | Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | c. Infrastrukturën e transportit dhe transportin publik<br>d. Infrastrukturën publike<br>e. Infrastrukturën sociale<br>f. Mjedisin dhe sipërfaqet me rrezikshmëri<br>g. Asetet e trashëgimisë natyrore, kulturor dhe turistike<br>h. Vendbanimet<br>i. Shfrytëzimin e tokës | | | |
| 2.Përgaditja e Kornizës së Zhvillimit Hapësinor | A. Përgatitja e Kornizës së Zhvillimit Hapësinor dhe skenarëve të mundshëm<br>B. Shqyrtimi i Kornizës së Zhvillimit Hapësinor nga KD<br>C. Shqyrtimi i Kornizës së Zhvillimit Hapësinor nga GP<br>D. Shqyrtimi i Kornizës së Zhvillimit Hapësinor nga konsulentët<br>E. Inkorporimi i komenteve dhe sugjerimeve | Në mënyrë që të kompletohet Profili i PZHK-së nevojitet që të grumbullohen të dhënat e kërkuara sipas UA për PZHK. | 2 javë | KD,GP dhe Kompania konsulente |
| 3.Shqyrtimi publik i Vizionit, Qëllimeve, Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike dhe Kornizës së Zhvillimit Hapësinor | A. Përgatitja e shqyrtimit publik të Vizionit, Qëllimeve, Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike dhe Kornizës së Zhvillimit Hapësinor për prezantim publik<br>B. Zhvillimi i shqyrtimit publik të Vizionit, Qëllimeve, Objektivave | Në mënyrë që të kompletohet PZHK, të përkrahet dhe zbatohet nevojitet prezantimi i Vizionit, Qëllimeve, Objektivave dhe | 1 javë | Udhëheqësi komunal i projektit |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | dhe Prioriteteve Strategjike dhe Kornizës së Zhvillimit Hapësinor | Prioriteteve Strategjike dhe Kornizës së Zhvillimit Hapësinor | | |
| 4.Plotësimi dhe përfundimi i Vizionit, Qëllimeve, Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike dhe Kornizës së Zhvillimit Hapësinor | A. Inkorporimi i komenteve dhe sugjerimeve nga banorët | | 1 javë | Udhëheqësi komunal i projektit dhe Kompania konsulente |

6.Përgatitja e Planit të Veprimit, Dispozitave për Zbatim dhe Monitorim

| Detyrat | Aktivitetet | Qëllimi | Kohëzgjatja | Përgjegjësi |
|---|---|---|---|---|
| 1.Përgaditja e Planit të Veprimit, Dispozitave për Zbatim dhe Monitorim | A. Përcaktimi i Planit të Veprimit, Dispozitave për Zbatim dhe Monitorim për arritjen e qëllimeve dhe objektivave në fushën e :<br>a. Zhvillimit ekonomik<br>b. Infrastrukturës teknike<br>c. Infrastrukturës se transportit dhe transporti publik<br>d. infrastrukturës sociale<br>e. mjedisit dhe sipërfaqeve me rrezikshmëri<br>f. Infrastrukturës publike<br>g. Aseteve të trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike<br>h. Gjendjen ekzistuese të vendbanimeve<br>i. Shfrytëzimit të tokës | Në mënyrë që planifikimi të jetë i harmonizuar dhe i qëndrueshëm, nevojitet që të zhvillohet një punëtori me KD, punonjës të drejtorive komunale dhe pjesëtar tjerë të GP | 2 javë | Udhëheqësi komunal i projektit dhe Kompania konsulente |
| 2. Shqyrtimi i Planit të Veprimit, | A.Shqyrtimi i Planit të Veprimit, Dispozitave për | Në mënyrë që të përcaktohen | 1 javë | KD.GP dhe Kompania konsulente |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Dispozitave për Zbatim dhe Monitorim | Zbatim dhe Monitorim nga KD<br>B. Shqyrtimi I Planit të Veprimit, Dispozitave për Zbatim dhe Monitorim nga GP<br>C. Shqyrtimi I Planit të Veprimit, Dispozitave për Zbatim dhe Monitorim nga konsulentët<br>D.Inkorporimi I komenteve dhe sugjerimeve | veprimet sipas planeve sektoriale dhe kornizës kohore nevojitet shqyrtimi I Planit të Veprimit, Dispozitave për Zbatim dhe Monitorim | | |
| 3.Plotësimi dhe përfundimi I Shqyrtimi I Planit të Veprimit, Dispozitave për Zbatim dhe Monitorim | A.Inkorporimi I komenteve dhe sugjerimeve nga banorët | | I javë | Udhëheqësi komunal I projektit dhe kompania konsulente |

7.Konsolidimi dhe përfundimi I përmbajtjes së PZHK-së

| Detyrat | Aktivitetet | Qëllimi | Kohëzgjatja | Përgjegjësi |
|---|---|---|---|---|
| 1.Konsolidimi dhe përfundimi I përmbajtjes së PZHK-së | A.Përfundimi I kapitullit të sfondit<br>B.Konsolidimi I tërë dokumentit | Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë hartimit të PZHK-së | 2 javë | Udhëheqësi komunal I projektit dhe kompania konsulente |
| 2.Dorëzimi I PZHK-së në MEA për vlerësimin e përmbajtjes para zhvillimit të shqyrtimit publik | A.Dorëzimi I draftit përfundimtar të PZHK-së në MEA<br>B.Përgatitja e prezantimit të draftit përfundimtar të PZHK-së në MEA<br>C.Prezantimi I draftit përfundimtar të PZHK-së në në MEA<br>D.Miratimi I MEA-së për inicimin e shqyrtimit publik të draftit | Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë hartimit të PZHK-së | 2 javë | Udhëheqësi komunal I projektit |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | përfundimtar të PZHK-së në MEA | | | |

8.Shqyrtimi publik I PZHK-së

| Detyrat | Aktivitetet | Qëllimi | Kohëzgjatja | Përgjegjësi |
|---|---|---|---|---|
| 1.Vendimi për zhvillimin e shqyrtimit publik | A.Përgatitja e vendimit për shqyrtimin public të PZHK-së<br>B.Njoftimi I banorëve dhe akterëve tjerë për zhvillimin e shqyrtimit publik | Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë hartimit të PZHK-së | 1 javë | Kryetari I Komunës |
| 2.Zhvillimi I shqyrtimit publik | A.Hapja zyrtare e shqyrtimit public dhe prezantimi public I draftit përfundimtar të PZHK-së<br>B.Mbajtja e ekapozitës të përmbajtjes së draftit përfundimtar të PZHK-së<br>C.Pranimi I vërejtjeve, komenteve dhe sygjerimeve nga banorët | Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë hartimit të PZHK-së | 4 javë | Udhëheqësi komunal I projektit dhe kompania konsulente |
| 3.Raporti I shqyrtimit publik | A.Përgatitja e raportit të shqyrtimit publik | Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë hartimit të PZHK-së | 1 javë | Udhëheqësi komunal I projektit dhe kompania konsulent |
| 4.Inkorporimi I vërejtjeve, komenteve dhe sygjerimeve | A.Ndryshimi I PZHK-së në përputhje me vërejtjet, komentet dhe sygjerimet e arësyeshme të dorëzuara | Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë hartimit të PZHK-së | 1 javë | Udhëheqësi komunal I projektit dhe kompania konsulent |

9.Miratimi I PZHK-së

| Detyrat | Aktivitetet | Qëllimi | Kohëzgjatja | Përgjegjësi |
|---|---|---|---|---|
| 1.Miratimi I PZHK-së nga MEA | A.Dorëzimi I PZHK-së në MEA për miratim | Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë | 4 javë | Udhëheqësi komunal I projektit |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | hartimit të PZHK-së | | |
| 2.Miratimi i PZHK-së nga Kuvendi Komunal | A.Dorëzimi i PZHK-së në Kuvendin Komunal për miratim<br>B.Inkorporimi i komenteve dhe sygjerimeve nga Kuvendi Komunal nese ka<br>C.Miratimi i PZHK-së nga Kuvendi Komunal | Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë hartimit të PZHK-së | 2 javë | Kryetari i Komunës |


ALI NEZIRI
SYLEJMAN ABDYLI
ADEM ZEQIRI
ARIF SHALA
SYLEJMAN ABDYLI
DËSHMORËT E DUJAKËS